

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 569 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

**VENDIM Nr. 39, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të **Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore"** (i ndryshuar), **Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"** (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Ekspeditë Përnjohëse në Prapatokën e Durrachiumit"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Brikena Shkodra Rrugia (IA),

**VENDOSI:**

1. Të miratojë **Projektin kërkimor shkencor në vazhdim, Ekspeditë Përnjohëse në Prapatokën e Durrachiumit"**, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Dr. Brikena Shkodra Rrugia (IA), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Përqëndrimi i kërkimeve në dy drejtime: a) te territori përreth Durrësit; b) përgjatë shtrirjes së ujësjellësit dhe juglindor përgjatë shtrirjes së rrugës Egnatia".
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë 7-10 ditore, në muajin shtator, me qëllim daljen në terren në një periudhë tjetër të vitit për të vlersuar dhe shkelur hapësira të mbuluara nga vegjetacioni gjate dy fushatave të para.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETARI I KKA**  
**RUDINA ZOTO**



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)